

## **INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE**

### **“PËR STRUKTURËN, KRITERET E PËRZGJEDHJES DHE TRAINIMIN E PUNONJËSVE TË NJËSISË PËRGJËGJËSE NË SUBJEKTET PRIVATE NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 60/2016 “PËR SINJALIZIMIN DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE””**

Në zbatim të pikës 3 të nenit 10 të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI),

#### **U D H Ë Z O N:**

1. Përcaktimin e rregullave dhe procedurave për krijimin e strukturës, kriteret e përzgjedhjes dhe trainimin e punonjësve të njësisë përgjegjëse në subjektet private në zbatim të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.
2. Ngritja e njësisë përgjegjëse në subjektet private bazohet në nenin 10 të ligjit nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve” dhe:
  - a) për subjektet private që kanë 100 deri në 2 000 të punësuar përbëhet nga një punonjës.
  - b) për subjektet private me mbi 2 000 të punësuar njësia përgjegjëse përbëhet nga dy punonjës.
3. Njësia përgjegjëse, sipas pikës 2 të këtij udhëzimi, emërohet me urdhër të vecantë me shkrim të administratorit të subjektit privat ose të drejtuesit të pozicionit të barazvlefshëm me të.
4. Njësia përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr. 60/2016, si strukturë që ndjek në vazhdimësi sinjalizimin e një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni si dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nga hakmarrja në veprimtarinë e saj mban kontakte të vazhdueshme me ILDKPKI-në.
5. Anëtarët e njësisë përgjegjëse emërohen nga radhët e punonjësve të përhershëm të subjektit privat dhe duhet të përmbushin njëkohësisht këto kriteret:
  - a) të japin pëlqimin me shkrim për emërimin në detyrën e anëtarit të njësisë përgjegjëse;
  - b) të ketë vjetërsi në punë jo më pak se dy vjet;
  - c) të ketë mbaruar arsimin e lartë, i preferueshëm në shkencat juridike, shkencat sociale ose shkencat ekonomike.
6. Punonjësit e njësisë përgjegjëse emërohen në këtë detyrë pa afat.

7. Për çdo ndërprerje të marrëdhënies së punës mes subjektit privat dhe punonjësit të njësisë përgjegjëse informohet menjëherë ILDKPKI-ja. Subjekti privat merr masat e nevojshme që të zëvendësojë menjëherë punonjësin e larguar të njësisë përgjegjëse duke zbatuar kriteret e përcaktuara në këtë Udhëzim.

8. Punonjësit e njësisë përgjegjëse largohen nga kjo detyrë kur:

- a) japin dorëheqjen me shkrim, e cila i dërgohet njëkohsisht drejtuesit subjektit privat dhe ILDKPKI -së;
- b) dënohen me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- c) kryejnë shkelje të rëndë të legjislacionit që rregullon sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

9. Punonjësit e njësisë përgjegjëse në subjektet private i nënshtrohen trainimit të detyrueshëm për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësisë të përcaktuara në ligjin nr. 60/2016 dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Trainimi organizohet nga ILDKPKI -ja.

Koha e periudhës së trainimit, metodologjia e kryerjes së tij dhe lista e ekspertëve trainues dhe pagesa e tyre miratohet me urdhër të vecantë të Inspektorit të Përgjithshëm.

Shpenzimet e trainimit janë pjesë e buxhetit të ILDKPKI-së.

10. Subjektet private janë të detyruara të mundësojnë pjesëmarrjen në trainim nga punonjësit e njësive përgjegjëse, sa herë njoftohen paraprakisht nga ILDKPKI -ja.

11. ILDKPKI - ja krijon dhe mban të përditësuar Rregjistrin Kombëtar të Punonjësve të Njësive Përgjegjëse në Subjektet Private në zbatim të ligjit nr.60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".

12. Një kopje origjinale e urdhërit të emërimit, plotësimi i kriterëve të emërimit dhe *curriculum vitae* të punonjësit të njësisë përgjegjëse në subjektet private i dërgohet ILDKPKI-së, brenda 60 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi ose sipas rastit brenda 10 ditëve nga data e zëvendësimit të punonjësit të njësisë përgjegjëse.

13. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen subjektet private sipas përcaktimit të bërë në nenin 3 të ligjit nr. 60/2016 dhe këtij Udhëzimi.

14. Veprimtaria e njësive përgjegjëse në subjektet private në zbatim të ligjit nr. 60/2016 "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve" fillon në datën 1 korrik 2017.

Ky udhëzim hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

**INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM**

**Shkëlqim GANAJ**